<p>4. Për zbatimin e detyrave që kanë të bëjnë me Strategjinë e Energjisë, Ministria mund të miratojë legjislacion sekondar për themelimin, financimin dhe operimin e Zyrave Komunale të Energjisë, në rast se kjo është e domosdoshme për të adresuar çështjet e implementimit dhe monitorimit në nivel lokal.</p>	<p>4. Za ispunjavanje obaveza iz Energetske strategije, Ministarstvo može da usvoji sekundarne zakone za uspostavljanje, finansiranje i rad Komunalnih energetskih kancelarija tamo gde su one potrebne da bi se stvari u vezi sa realizacijom i nadgledanjem rešavale na lokalnom nivou.</p>	<p>4. For the implementation of the duties related to the Energy Strategy, the Ministry may adopt secondary legislation for the establishment, funding and operation of Communal Energy Offices where they are necessary to deal with implementation and monitoring matters at local level.</p>
<p>5. Ministritë dhe institucionet tjera të Qeverisë, përfshirë organet e qeverive lokale, do ta këshillojnë dhe ndihmojnë Ministrinë në implementimin e Programit të Zbatimit të Strategjisë së Energjisë, deri në masë që është në pajtim me detyrat dhe autorizimet e tyre.</p>	<p>5. Ministarstva i druge državne institucije, uklju uju i organe lokalne samouprave, savetuju i pomažu Ministarstvu u primeni Programa realizacije Energetske strategije, do more koja je u skladu sa njihovim širim dužnostima i ovlaš enjima.</p>	<p>5. Ministries and other Government institutions, including local government bodies, shall advise and assist the Ministry in the implementation of the Energy Strategy Implementation Programme, to the extent that is consistent with their wider duties and powers.</p>
<p>6. Ndërmarrja energjetike dhe personat tjerë do të jenë të obliguar t'i përmbahen politikave dhe obligimeve që rrjedhin nga Strategjia e Energjisë dhe Programi i Zbatimit të Strategjisë së Energjisë, deri në masën e përcaktuar në Programin e</p>	<p>6. Energetsko preduze e i druga lica dužni su da poštuju politiku i obaveze koje proizilaze iz Programa realizacije Energetske strategije do mere koja je predvi ena Programom realizacije Energetske strategije. Ako poštovanje</p>	<p>6. Energy enterprise and other persons shall be required to adhere policies and obligations deriving from the Energy Strategy or Energy Strategy Implementation Programme to the extent that is specified in the Energy Strategy</p>



<p>Zbatimit të Strategjisë së Energjisë. Në rastet kur pajtueshmëria me këto politika apo obligime ka të ngjarë të rezultojë me kosto shtesë që mbulohen nga ndërmarrjet energjetike, Ministria, në bashkëpunim me Zyrën e Rregullatorit për Energji, bën aranzhime për të siguruar që:</p> <p>6.1 këto shpenzime shtesë të imponohen në mënyrë transparente dhe jodiskriminuese, dhe që</p> <p>6.2 ndërmarrjet energjetike të jenë në gjendje t'i mbulojnë këto shpenzime të arsyeshme shtesë, përmes mjeteve tjera dhe detyrimeve tek konsumatorët.</p> <p>7.Ministria paraqet raportin vjetor para Qeverisë së Republikës së Kosovës, mbi progresin në realizimin e Programit të Zbatimit të Strategjisë së Energjisë, si dhe nivelin e zbatimit të Strategjisë së Energjisë. Të gjithë raportet përfshijnë hollësi mbi përparimin përkatës në zbatimin e Programit të Zbatimit të Strategjisë së Energjisë, në periudhën e mbuluar nga raporti, dhe do t'i theksojnë zhvillimet që priten në periudhën e mbetur të Programit.</p>	<p>takve politike i obaveza zahteva dodatne troškove koji se pokrivaju iz energetskih preduze a, Ministarstvo je dužno da, u saradnji sa Energetskom regulatornom kancelarijom, stvori uslove da bi obezbedilo:</p> <p>6.1.da su takvi dodatni troškovi nametnuti na na in koji je transparentan i koji nije diskriminacioni, i</p> <p>6.2 da su energetska preduze a u stanju da se operave od svih takvih dodatnih troškova koje ona razumno stvore posredstvom naplate od potroša a i sli no.</p> <p>7. Ministarstvo podnosi godišnje izveštaje Vladi Republike Kosova u kojima je predstavljen napredak u primeni Programa realizacije Energetske strategije, kao i nivo realizacije Energetske strategije. Svaki takav izveštaj mora da sadrži detalje napretka u vezi sa Programom realizacije Energetske strategije u periodu koji je pokriven izveštajem, kao i razvoje u pogledu ostatka perioda primene Programa.</p>	<p>Implementation Programme. Where adherence of such policies or obligations is likely to result in additional costs being incurred by energy enterprises, the Ministry shall, in collaboration with the Energy Regulatory Office, make arrangements to ensure that:</p> <p>6.1 such additional costs are imposed in a transparent and non-discriminatory way, and</p> <p>6.2 energy enterprises are able to recover all such additional costs that they reasonably incur by means of charges to consumers and other.</p> <p>7.The Ministry shall submit annual reports to the Government of the Republic of Kosovo, outlining the progress on the realization of the Energy Strategy Implementation Programme, and the implementation level of the Energy Strategy. All such reports shall include details of progress relative to the Energy Strategy Implementation Programme in the period covered by the report, and outline developments expected over the remainder of the timescale for the Programme.</p>
---	---	--



<b>Neni 5</b>	<b>lan 5</b>	<b>Section 5</b>
<p data-bbox="254 321 684 354"><b>Balanca Kombëtare e Energjisë</b></p> <p data-bbox="186 358 751 902">1.Ministria miraton parashikimin e balancës afatgjate dhe vjetore të energjisë si dhe e publikon atë, në pajtim me dispozitat e këtij neni.Në balancën e energjisë paraqitet parashikimi për kërkesën totale për energji dhe përbërjen e saj, llojet e burimeve të energjisë që priten të jenë në dispozicion, si dhe masat zbatuese për përmbushjen e kërkesës me energji. Balanca afatgjate dhe vjetore e energjisë elektrike i propozohet Ministrisë nga Operatori i Sistemit të Transmisionit, pas konsultimeve me Zyrën e Rregullatorit të Energjisë, Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes dhe furnizuesit e licencuar.</p> <p data-bbox="186 943 751 1341">2.Balanca afatgjate e energjisë është parashikim i një periudhe 10 vjeçare dhe miratohet nga Ministria, e cila atë e publikon jo më vonë se më datën 1 dhjetor për çdo dy vite. Parashikimet e balancave vjetore të energjisë miratohen dhe publikohen së paku një muaj para fillimit të vitit të cilit i përkasin. Balanca vjetore e energjisë për vitin paraprak do të miratohet dhe publikohet brenda gjashtë muajve të parë të vitit vijues.</p> <p data-bbox="186 1382 751 1448">3.Operatori i Sistemit të Transmisionit, duhet të konsultohet me Zyrën e</p>	<p data-bbox="869 321 1228 354"><b>Nacionalni bilans energije</b></p> <p data-bbox="772 358 1325 902">1.Ministarstvo je dužno da usvoji i objavi plan i za dugoro ni i za godišnji bilans energije kako je predvi eno ovim lanom. Bilans energije obuhvata predvi enu ukupnu potražnju za energijom i njen sastav, vrstu energetskih resursa za koje se o ekuje da e biti dostupni, kao i mere realizacije potrebne za zadovoljavanje potražnje za energijom. Dugoro ni i godišnji bilans energije predlažu Ministarstvu operateri sistema prenosa, nakon konsultovanja sa Energetskom regulatornom kancelarijom, operateri distribucionog sistema i licencirani snabdeva i.</p> <p data-bbox="772 943 1325 1308">2.Dugoro ni bilans energije pokriva period od 10 godina a usvaja ga i objavljuje Ministarstvo najkasnije do 1. decembra svake druge godine. Godišnji bilans energije usvaja se i objavljuje godišnje, bar mesec dana pre po etka godine na koju se odnosi. Godišnji bilans energije za prethodnu godinu usvaja se i objavljuje u roku od prvih šest meseci teku e godine.</p> <p data-bbox="772 1382 1325 1448">3.Operatori Sistema Prenosa dužni su da se konsultuju sa Energetskom</p>	<p data-bbox="1421 321 1822 354"><b>The National Energy Balance</b></p> <p data-bbox="1348 358 1900 870">1.The Ministry shall adopt and publish forecasts for both long-term and annual energy balances as provided in this Section. Energy balances shall include forecasts of the total energy demand and its composition, types of energy resources expected to be available, and implementation measures required to meet the energy demand. Long-term and annual energy balances shall be proposed to the Ministry by the transmission system operators, after consultations with the Energy Regulatory Office, distribution system operators and licensed suppliers.</p> <p data-bbox="1348 943 1900 1341">2. The long-term energy balance will forecast over a 10 year period, and will be adopted and published by the Ministry no later than 1 December of every other year. Annual energy balances forecasts shall be adopted and published annually, at least one month before the start of the year to which they relate. The annual energy balance for the previous year shall be adopted and published within the first six months of the current year.</p> <p data-bbox="1348 1382 1900 1448">3.The Transmission System Operators shall consult with the Energy Regulatory</p>



<p>Rregullatorit për Energji, sa i përket planifikimit të parashikimeve të nevojshme të balancave të energjisë, dhe do të merr parasysh këto konsultime gjatë përgatitjes së propozimeve për metodologjinë. Pas konsultimit me Zyrën e Rregullatorit për Energji, operatori i sistemit të transmissioinit zhvillon dhe ia propozon Ministrisë për aprovim, metodologjinë për parashikimet e nevojshme për balancën afatgjate dhe vjetore të energjisë elektrike.</p> <p>4.Ministria nxjerr metodologjinë e miratuar që duhet zbatuar nga operatorët e sistemit të transmissioinit në metodologjinë e parashikimit dhe proceset e grumbullimit të të dhënave për sajimin e balancës së energjisë.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 6</b> <b>Roli i qeverisjes lokale</b></p> <p>1.Organet e qeverisjes lokale duhet që në dokumentet e tyre zhvillimore të planifikojnë nevojat dhe mënyrën e furnizimit me energji dhe ato dokumente t'i harmonizojnë me Strategjinë e Energjisë dhe Programin për Zbatimin e Strategjisë, si dhe balanceve të energjisë.</p> <p>2.Përveç atyre që theksohen në paragrafin 1, të këtij neni organet e qeverisjes lokale</p>	<p>regulatornom kancelarijom oko razvoja planova neophodnih za bilans energije i da tu konsultaciju imaju u vidu tokom pripreme predloga za metodologiju. Nakon konsultacije sa Energetskom regulatornom kancelarijom, operateri sistema prenosa dužni su da osmisle i predlože Ministarstvu na usvajanje metodologiju za planove neophodne za godišnji i dugoro ni bilans energije.</p> <p>4.Ministarstvo je izdaje usvojenu metodologiju koju su operateri sistema prenosa dužni da poštuju za metodologiju predvi anja i procese prikupljanja podataka koji se poštuju za razvoj bilansa energije.</p> <p style="text-align: center;"><b>Ilan 6</b> <b>Uloga lokalnog upravljanja</b></p> <p>1.Opštinski organi upravljanja treba da u njihovim razvojnim dokumentima planiraju potrebe i na in snabdevanja energijom i da ta dokumenta treba da usaglase sa Strategijom za energiju i Program za sprovo enje strategije, kao i bilansama o energiji.</p> <p>2.Osim onoga što je naglašeno u stavu 1, Opštinski organi upravljanja treba da</p>	<p>Office on the development of forecasts necessary for energy balances, and take account of such consultation in their preparation of proposals for a methodology. Following consultation with the Energy Regulatory Office, the transmission system operators shall develop and propose to the Ministry for approval a methodology for the forecasts necessary for the annual and long-term energy balances.</p> <p>4. The Ministry shall issue an approved Methodology to be followed by the transmission system operators for the forecasting methodology and data collection processes to be followed for energy balance development.</p> <p style="text-align: center;"><b>Section 6</b> <b>Role of Local Government</b></p> <p>1.Local government bodies shall plan, in their development documents, the need and the manner of energy supply and shall harmonize those documents with the Energy Strategy Implementation Programme, and energy balances.</p> <p>2.In addition to those mentioned in paragraph 1. for this section, local</p>
---	--	--



<p>duhet të bashkëpunojnë edhe me Ministrinë në lidhje me të drejtën për qasje në tokë ku duhet të vendosen pajisjet dhe stabilimentet energjetike.</p>	<p>sara uju sa Ministarstvom i u vezi sa pravom za pristup na zemljišta u kojima treba da se uspostavlja oprema i energetska postrojenja.</p>	<p>government bodies shall also cooperate with the Ministry on issues of the right of access to lands for the placement of energy equipment and energy facilities.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 7</b> <b>Planet Zhvillimore të Operatorëve të Sistemeve të Transmisionit dhe Shpërndarjes</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>lan 7</b> <b>Razvojni Planovi Operatera Sistema Prenosa i Distribucije</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Section 7</b> <b>Development Plans of Transmission and Distribution System Operators</b></p>
<p>1.Operatorët e sistemit të transmisionit dhe shpërndarjes përgatisin dhe publikojnë planet zhvillimore afatmesme dhe afatgjata, që mbulojnë periudha prej 3 apo më shumë viteve kalendarike. Këto plane zhvillimore duhet të jenë në pajtim me obligimet e tyre sipas licencave dhe në pajtueshmëri me Strategjinë e Energjisë, Programin e Zbatimit të Strategjisë dhe balancat e energjisë.</p> <p>2.Planet zhvillimore të përgatitura nga operatorët e sistemit të transmisionit dhe shpërndarjes njohin:</p> <p>2.1 rëndësinë e mirëmbajtjes së rregullt dhe, sipas nevojës, rinovimin e rrjetit të transmisionit dhe shpërndarjes si elemente zhvillimore, për mirëmbajtjen e performancës së rrjeteve;</p>	<p>1.Operatori sistema prenosa i distribucije pripremaju i objavljuju srednoro ne i dugoro ne razvojne planove koji pokrivaju period idu ih tri ili više kalendarskih godina. Takvi razvojni planovi moraju da budu u skladu sa njihovim obavezama pod licencom i kompatibilni sa Energetskom strategijom, Programom realizacije Strategije i bilansom energije.</p> <p>2.Razvojni planovi koje pripremaju operateri sistema prenosa i distribucije moraju prepoznati:</p> <p>2.1 važnost redovnog održavanja i, kada je to potrebno, obnavljanja mreža prenosa i distribucije da bi se održao u inak mreža;</p>	<p>1.Transmission and distribution system operators shall prepare and publish medium and long-term development plans that cover periods of the next 3 or more calendars years. Such development plans shall be consistent with their obligations under the licenses and compatible with the Energy Strategy, the Strategy Implementation Programme, and energy balances.</p> <p>2.Development plans prepared by the transmission and distribution system operators shall recognize:</p> <p>2.1 the importance of regular maintenance and, where necessary, renewal of the transmission and distribution networks to maintain the performance of the networks;</p>



<p>2.2 rëndësinë e të siguruarit të këmbimit të informatave në mes veti si dhe me operatorët e tjerë të sistemit, si në Kosovë ashtu dhe sistemet tjera, mbi veprimtarinë e rrjetit, në kohë të duhur dhe në baza efektive;</p> <p>2.3 nevojën për të përmbushur të gjithë objektivat e performancës që kanë të bëjnë sistemet e tyre të cilët vendosen në pajtim me licencat e tyre apo rregullat apo kodet tjera;</p> <p>2.4 nevojën për të siguruar kapacitet të mjaftueshëm rezervë në sistemin e transmissioinit që akomodon prodhim stabil për operim të qëndrueshëm të sistemi;</p> <p>2.5 në rastin e operatorit të sistemit të transmissioinit, nevojën për të ndërmarrë hapa në avancimin e shfrytëzimit të kapaciteteve rezervë të prodhimit për të ngritur besueshmërinë e furnizimit, gjithnjë në pajtueshmëri me kërkesat që dalin nga kodet të nënshtruara një dinamike zhvillimore;</p> <p>2.6 nevojën për shfrytëzimin sa më të efektshëm të interkonektorëve ekzistues; dhe</p> <p>2.7 dëshirën për të siguruar nivel më të lartë të interkoneksioinit me sistemet</p>	<p>2.2 važnost obezbe ivanja razmene informacija o funkcionisanju mreže sa drugim operaterima sistema, i na Kosovu i u drugim sistemima, redovno i delotvorno;</p> <p>2.3 potrebu da se zadovolje svi ciljevi u inka važni za njihove sisteme, a koji su utvr eni u skladu sa njihovom licencom ili drugim pravilima, ili kodeksima;</p> <p>2.4 potrebu da se obezbedi dovoljan rezervni kapacitet prenosa i proizvodnje za stabilno funkcionisanje;</p> <p>2.5 u slu aju operatera sistema prenosa, potrebu da se preduzmu koraci da bi se obezbedio odgovaraju i rezervni kapacitet proizvodnje, do mere do koje je operater sistema prenosa u stanju da tako postupa u okviru kodeksa koji se primenjuju s vremena na vreme;</p> <p>2.6 potrebu za postoje im povezanim mrežama koje se moraju koristiti što je delotvornije mogu e; i</p> <p>2.7 želju da se obezbedi odgovaraju i nivo povezanosti sa evropskim energetskim</p>	<p>2.2 the importance of ensuring that they exchange information on network operations with other system operators, both in Kosovo and in other systems, on a timely and effective basis;</p> <p>2.3 the need to satisfy all the performance objectives relative to their systems that are set in accordance with their licenses or other rules or codes;</p> <p>2.4 the need to ensure sufficient transmission and generation reserve capacity for stable operation;</p> <p>2.5 in the case of the transmission system operator, the need to take steps to secure an appropriate generation reserve capacity, to the extent that the transmission system operator is able to do so within the codes that apply from time to time;</p> <p>2.6 the need for existing interconnectors to be used as efficiently as possible;</p> <p>2.7 the desirability of ensuring an appropriate level of interconnection with</p>
--	--	---



<p>energjete të Evropës në mënyrë që të mundësohet zhvillimi i tregut rajonal të energjisë, duke marrë parasysh kostot e ndërtimit të interkoneksioneve të reja krahas përfitimeve për konsumatorët.</p> <p>3. Të gjithë planet zhvillimore të përgatitura nga operatorët e sistemit të transmissioinit apo shpërndarjes duhet të dorëzohen në Ministri për rishikim. Ministria shqyrton planet e tilla zhvillimore dhe mund të publikojë një mendim në lidhje me nivelin e pajtueshmërisë së atij plani me Strategjinë e Energjisë, Programin e Zbatimit të Strategjisë dhe Balancës së Energjisë, dhe ligjin. Të gjitha parashtrimet e tilla apo mendimet e publikuara nuk do të ndikojnë në termat kohor dhe nuk do të zvogëlojnë apo ndryshojnë obligimet e operatorëve të sistemit të transmissioinit dhe shpërndarjes për dorëzimin e planeve të tilla në Zyrën e Rregullatorit të Energjisë në pajtim me kërkesat e përcaktuara në termat dhe kushtet e licencave të tyre, apo në rregullat ose kodet tjera.</p>	<p>sistemima da bi se omoguio razvoj regionalnog enerjetskog tržišta, uzimaju i u obzir troškove izgradnje povezanih mreža koje bi bile od koristi za potroša e.</p> <p>3. Svaki razvojni plan koji pripreme operateri sistema prenosa ili distribucije mora se podneti Ministarstvu na pregled. Ministarstvo je dužno da razmotri svaki takav razvojni plan i može objaviti mišljenje u pogledu mere do koje se smatra da je takav plan u skladu sa Enerjetskom strategijom, Programom realizacije Strategije i Bilansom energije, kao i zakonom. Svaki takav podnesak ili objavljeno mišljenje ne sme smanjiti ili promeniti obaveze operatera sistema prenosa i distribucije da podnesu takve planove Enerjetskoj regulatornoj kancelariji u skladu sa uslovima utvr enim u opisu prava i dužnosti u njihovoj licenci, ili u drugim pravilima, ili kodeksima.</p>	<p>European energy systems to facilitate the development of the regional energy market, taking account of the costs of building new interconnections relative to the benefits to customers.</p> <p>3. Any development plan prepared by transmission or distribution system operators must be submitted to the Ministry for review. The Ministry shall review any such development plan and may publish an opinion regarding the extent to which such plan is deemed consistent with the Energy Strategy, Strategy Implementation Programme and Energy Balance, and the law. Any such submission or published opinion shall not reduce or change the obligations of transmission and distribution system operators to submit such plans to the Energy Regulatory Office in accordance with requirements set forth in the terms and conditions of their licenses, or in other rules or codes.</p>
---	--	---





<p style="text-align: center;"><b>KREU III</b> <b>EFIÇIENCA E ENERGJISË,</b> <b>BURIMET E RIPËRTRISHME DHE</b> <b>BASHKËPRODHIMI</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>POGLAVLJE III</b> <b>ENERGETSKA EFIKASNOST,</b> <b>OBNOVLJIVI IZVORI ENERGJIJE,</b> <b>ZAJEDNI KA PROIZVODNJA</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>TITLE III</b> <b>ENERGY EFFICIENCY,</b> <b>RENEWABLE ENERGY SOURCES,</b> <b>CO-GENERATION</b></p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 8</b> <b>Efiçienca e energjisë</b></p> <p>1.Politika e efiçencës së energjisë është pjesë përbërëse e Strategjisë së Energjisë dhe fushëveprimi dhe përmbajtja e saj duhet të jetë në harmoni me direktivat aktuale të Komunitetit Evropian dhe legjislacionit përkatës.</p> <p>2.Qëllimi i politikës së efiçencës së energjisë është përmirësimi i efiçencës së energjisë dhe shfrytëzimi i potencialeve kursyese të energjisë me qëllim të arritjes se nivelit optimal të efiçencës së energjisë në Kosovë.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Ian 8</b> <b>Politika energetike efiçente</b></p> <p>1.Politika energetike efiçente je sastavni deo Energetske strategije, a njen delokrug i sadržaj moraju da budu u skladu sa postoje im direktivama i drugim zakonima Evropske Zajdenice.</p> <p>2.Svrha Politike energetike efiçente jeste da se unapredi energetska efiçentost i koriš enje potencijala za uštedu energije sa ciljem da se ostvare ciljevi optimalnog nivoa energetske efiçentosti na Kosovu</p>	<p style="text-align: center;"><b>Section 8</b> <b>Energy Efficiency Policy</b></p> <p>1.Energy Efficiency Policy shall be an integral part of the Energy Strategy, and its scope and content shall be harmonized with the current European Community directives and other legislation.</p> <p>2.The purpose of the Energy Efficiency Policy shall be to improve the energy efficiency and the use of energy saving potentials with a view to achieving an optimal level of energy efficiency in Kosovo.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 9</b> <b>Zbatimi i politikës së efiçencës së energjisë</b></p> <p>1.Për zbatimin e politikës së efiçencës së energjisë, Ministria duhet te:</p> <p>1.1 harton planin 10 vjeçar dhe 3 vjeçar të veprimet për zhvillim të efiçencës së energjisë, në përputhje me kërkesat e KE-</p>	<p style="text-align: center;"><b>Ian 9</b> <b>Sprovo enje politike energetike efiçente</b></p> <p>1.Za sprovo enje politike energetike efiçente, Ministarstvo e uesti:</p> <p>1.1 priprema 10 godisnji i 3 godisnji plan za razvoj energetske efiçentosti u skladu sa uslovima EK, uklju uju i cilj, nivo</p>	<p style="text-align: center;"><b>Section 9</b> <b>Implementation of Energy Efficiency Policy</b></p> <p>1.For the implementation of the Energy Efficiency Policy, the Ministry shall:</p> <p>1.1 prepare 10-year and 3-year action energy efficiency plans for development, in accordance with EC requirements,</p>





<p>së, përfshirë cakun dhjetëvjeçar për kursim të energjisë;</p> <p>1.2 mbikëqyr zbatimin e planeve të veprimit për zhvillim të efijencës së energjisë dhe përmbushjen e caqeve të specifikuara të kursimit të energjisë;</p> <p>1.3 përkujdeset për përmirësime në nivelin e efijencës së energjisë në ndërtesa dhe rregullimet për certifikimin energjetik të ndërtesave;</p> <p>1.4 nxitë procesin e auditimit të energjisë, si dhe planet zhvillimore komunale për efijencën e energjisë;</p> <p>1.5 publikon të dhëna lidhur me nivelet dhe zhvillimet e efijencës së energjisë;</p> <p>1.6 përgatitë dhe miraton akte nënligjore, në konsultim dhe bashkëpunim me Zyrën e Rregullatorit për Energji, për nxitjen e promovimit të efijencës së energjisë;</p> <p>1.7 nxitë organizatat joqeveritare të vepronë në sektorin e energjisë në mënyrë që të ndikojnë në kursimin e energjisë;</p> <p>2. Agjencia për Efijencë të Energjisë, e cila themelohet me ligj të veçantë, do të</p>	<p>uštede energji za period od deset godina;</p> <p>1.2 nadgleda sprovo enje razvojnih planova o energetske efikasnosti i realizaciju navedenih ciljeva za uštedu energije;</p> <p>1.3 teži unapre enju nivoa energetske efikasnosti objekata i uslova za energetsku proveru objekata;</p> <p>1.4 podsti e proces energetske revizije i lokalne razvojne planove o uštedi energije;</p> <p>1.5 objavljuje informacije u vezi sa nivoom i razvojem energetske efikasnosti;</p> <p>1.6 izra uje i usvaja podzakonske akte, nakon konsultacije sa Energetskom regulatornom kancelarijom za promovisanje efikasnog koriš enja energije;</p> <p>1.7 podsti e nevladine organizacije da deluju u energetskom sektoru da bi uticali na uštedu energije.</p> <p>2. Za sprovo enje politike energetske efikasnosti, u skladu sa Programom</p>	<p>including a ten-year target figure for energy saving;</p> <p>1.2 monitor the implementation of the energy efficiency development plans and the realization of specified targets for energy savings;</p> <p>1.3 foster improvements in the energy efficiency level of buildings, and arrangements for energy certification of buildings;</p> <p>1.4 encourage an energy audit process and local energy saving development plans;</p> <p>1.5 publish information on energy efficiency levels and developments;</p> <p>1.6 draft and adopt secondary legislation, after consulting the Energy Regulatory Office, for the promotion of efficient use of energy;</p> <p>1.7 encourage non-governmental organizations to operate in the energy sector in order to influence energy saving.</p> <p>2. The Agency for Energy Efficiency , which shall be established with a separate</p>
---	--	---



<p>jetë në krye të zbatimit të politikave të efijencës së energjisë, në pajtim me Programin e Zbatimit të Strategjisë së Energjisë.</p> <p>3.Organizimi, financimi dhe obligimet e Agjencisë për Efijencë të Energjisë përcaktohen me ligj të veçantë që trajton themelimin e saj.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 10</b> <b>Informatat mbi konsumin e energjisë në funksion të përmirësimit të efijencës së energjisë</b></p> <p>Ndërmarrjet energjetike duhet që së paku një herë në vit t'i informojnë konsumatorët e tyre lidhur me zhvillimet në konsumin e energjisë dhe masat për përmirësimin e efijencës së energjisë, si dhe mbi rëndësinë e zvogëlimit të shfrytëzimit të energjisë, si dhe të nxisin e udhëzojnë ata për një shfrytëzim efikas të energjisë dhe masat për kursimin e energjisë.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 11</b> <b>Etiketimi i Energjisë</b></p> <p>1.Prodhuesit dhe importuesit e produkteve që konsumojnë energji duhet të cekin në mënyrë të qartë specifikimet teknike të</p>	<p>realizacije Energetske strategije, odgovorna je Agencija za energetske efikasnost, koja se uspostavlja posebnim zakonom.</p> <p>3.Organizacija, finansiranje i dužnosti Agencije za energetske efikasnost i navedeni su u posebnom zakonu koji predvi a njeno uspostavljanje.</p> <p style="text-align: center;"><b>Ian 10</b> <b>Informacije o potrošnji energije vezi sa energetske efikasnoš u</b></p> <p>Energetska preduze a su dužna da, najmanje jednom godišnje, informišu svoje potroša e o stanju oko potrošnje energije i merama za unapre enje energetske efikasnosti, o važnosti smanjivanja koriš enja energije i da ih podsti u i upu uju na efikasno koriš enje energije, kao i na koriš enje mera za uštedu energije.</p> <p style="text-align: center;"><b>Ian 11</b> <b>Energetska etiketiranja</b></p> <p>1.Proizvo a i i uvoznici proizvoda koji troše energiju dužni su da jasno navedu tehni ku specifikaciju svojih proizvoda</p>	<p>law, shall be charged with the implementation of energy efficiency policies, in line with the Energy Strategy Implementation Programme.</p> <p>3.The organization, funding, and duties of the Agency for Energy Efficiency and will be specified in the separate law dealing with its establishment.</p> <p style="text-align: center;"><b>Section 10</b> <b>Information on Energy Consumption related to Energy Efficiency</b></p> <p>Energy enterprises shall, at least once a year, inform their customers on developments in energy consumption and in energy efficiency improvement measures, on the importance of reducing energy use, and encourage and guide them towards the efficient use of energy, and the use of energy saving measures.</p> <p style="text-align: center;"><b>Section 11</b> <b>Energy Labelling</b></p> <p>1.Manufacturers and importers of energy consuming products shall clearly indicate the technical specification of their</p>
--	--	---



<p>produkteve të tyre, përfshirë shumën e lëndës djegëse apo energjisë që konsumohet gjatë operimit normal. Ata, po ashtu, bashkëngjisin etiketën e efijencës së energjisë në produktet e tyre, në pajtim me dispozitat e këtij neni. Prodhuesit dhe importuesit, megjithatë, mund të zgjidhin të vendosin informata mbi efijencën e energjisë në pajisjet të cilat nuk i nënshtrohen etiketimit të detyrueshëm.</p> <p>2.Ministria, në legjislacionin sekondar përkthyer formën dhe përmbajtjen e etiketave informative të efijencës së energjisë që do t'i bashkëngjiten produkteve, mënyrën e matjes dhe përcaktimit të konsumit të energjisë dhe karakteristikat tjera të produktit, si dhe metodën për klasifikimin e produktit përkthyer me nivelin e efijencës së energjisë. Etiketat dhe procedurat relevante për etiketim për pajisjet elektrike shtëpiake janë në harmoni me Direktivat e Komunitetit Evropian dhe legjislacionit tjetër në fuqi mbi etiketimin energjik të pajisjeve elektrike shtëpiake.</p> <p>3.Legjislacioni sekondar i referuar në paragrafin 2 të këtij neni përcakton edhe llojet e produkteve për të cilat etiketat informative të efijencës së energjisë janë të obligueshme.</p>	<p>koja obuhvata koli inu goriva ili energije koju troše pod normalnim uslovima rada. Dužni su tako e, da svojim proizvodima pridodaju i etiketu energetske efikasnosti, u skladu sa odredbama ovoga lana. Me utim, proizvo a i i uvoznici mogu slobodno da postavljaju etikete o energetske efikasnosti i na opremi koja predmet obaveze postavljanja etikete.</p> <p>2.Ministarstvo odluje putem podzakonskih akata o obliku i sadržaju etiketa o energetske efikasnosti koje se stavljaju na proizvode, o na inu merenja i konstatacije o potrošnje energije, kao i o ostalim karakteristikama proizvoda, i o metodama klasifikacije proizvoda prema nivou energetske efikasnosti. Etikete i procedure u vezi postavljanjem etiketa na aparatima za doma instvo moraju biti u skladu sa direktivama Evropske unije i drugim važe im zakonima, a koji se odnose na ozna avanje energetske efikasnosti na aparatima za doma instvo.</p> <p>3.Podzakonska akta na koje upu uje stav 2. ovog lana tako e, utvr uje vrste proizvoda za koje je obavezno prikazivanje informacija o energetske efikasnosti.</p>	<p>products, including the amount of fuel or energy consumed during normal operations. They shall also attach an energy-efficiency label to their products, in line with the provisions of this Section. The manufacturers and importers, however, are free to place energy efficiency information labels on equipment which are not subjected to mandatory labelling.</p> <p>2.The Ministry shall prescribe in secondary legislation the form and content of the energy efficiency information labels to be attached to products, the manner of measuring and determining energy consumption, and other characteristics of the product, and the method for classifying the product with regard to its energy efficiency level. The labels and the procedures relevant to the labelling of household appliances shall be harmonized with European Community Directives and other applicable legislation issued and effective regarding the energy labelling of household appliances.</p> <p>3.The secondary legislation referred to in paragraph 2 of this Section will also stipulate the types of products for which energy efficiency information labels are compulsory.</p>
---	--	---



<p>4.Nëse Ministria nxjerr legjislacion sekondar, dispozitat e këtij neni zbatohen edhe për certifikimin energjetik të ndërtesave, në pajtim me atë legjislacion sekondar.</p> <p>5.Ministria, në legjislacionin sekondar, përcakton edhe nivelet maksimale për konsum të energjisë elektrike për paisjet e reja shtëpiake dhe pajisjet që tejkalojnë nivelin maksimal të konsumit të energjisë nuk do të lejohen të prodhohen, shitën apo importohen në Kosovë.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 12</b> <b>Politika për Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë dhe Bashkëprodhimin</b></p> <p>1.Qëllimi i politikës së burimeve të ripërtëritshme të energjisë dhe bashkëprodhimit është nxitja e shfrytëzimit të burimeve të ripërtëritshme të energjisë dhe bashkëprodhimit, me qëllim të përmbushjes së niveleve të caktuara të përdorimit të burimeve të ripërtëritshme të energjisë dhe bashkëprodhimit në Kosovë.</p> <p>2.Politika e burimeve të ripërtëritshme të energjisë dhe bashkëprodhimit është pjesë përbërëse e Strategjisë së Kosovës të Energjisë.</p>	<p>4.Odredbe ovog lana mogu, kada Ministarstvo donese podzakonske akte, da se primenjaju i za energetske proveru objekata, u skladu sa takvim podzakonskim aktima.</p> <p>5.Ministarstvo tako e, može da putem takvih podzakonskih akata utvrdi maksimalni nivo potrošnje energije za nove aparate za doma instvo, a svaka druga oprema koja prekora uje maksimalni nivo potrošnje energije se ne sme proizvoditi, prodavati ili uvoziti na Kosovu.</p> <p style="text-align: center;"><b>lan 12</b> <b>Politika obnovljivih izvora energije i zajedni ke proizvodnje</b></p> <p>1.Cilj Politike obnovljivih izvora energije i zajedni ke proizvodnje jeste da podstakne koriš enja obnovljivih izvora energije i zajedni ku proizvodnju, sa ciljem da se postigne ciljani nivo koriš enja obnovljivih izvora energije i zajedni ke proizvodnje na Kosovu.</p> <p>2.Politika obnovljivih izvora energije i zajedni ke proizvodnje je sastavni deo Energetske strategije.</p>	<p>4.The provisions of this Section may, where the Ministry issues secondary legislation, also apply for energy certification of buildings, in accordance with such secondary legislation.</p> <p>5.The Ministry may also determine in such secondary legislation the maximum energy consumption levels for new home appliances, and any equipment that exceeds the maximum level of energy consumption shall not be allowed to be manufactured, sold, or imported in Kosovo.</p> <p style="text-align: center;"><b>Section 12</b> <b>Policy for Renewable Energy Sources and Co-generation</b></p> <p>1.The aim of the Renewable Energy Sources and Co-generation Policy is to encourage the use of renewable energy sources and co-generation, with a view to achieving the targeted levels of usage of renewable energy sources and co-generation in Kosovo.</p> <p>2.The Renewable Energy Sources and Co-generation Policy is an integral part of the Energy Strategy.</p>
--	--	--



<p style="text-align: center;"><b>Neni 13</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Zbatimi i politikës së burimeve të ripërtëritshme të energjisë dhe bashkëprodhimit</b></p> <p>1.Për zbatimin e politikës së burimeve të ripërtëritshme të energjisë dhe bashkëprodhimit, Ministria:</p> <p>1.1 harton planin afatmesëm dhe afatgjatë të veprimit për burime të ripërtëritshme të energjisë dhe bashkëprodhimin, sipas kërkesave të Komunitetit Evropian;</p> <p>1.2 mbikëqyr zbatimin e politikës për burimet e ripërtëritshme të energjisë dhe bashkëprodhimit;</p> <p>1.3 përcakton caqet e energjisë së ripërtëritshme për shfrytëzimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë dhe bashkëprodhimit.</p>	<p style="text-align: center;"><b>lan 13</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Sprovo enje obnovljivih izvora energije i zajedni ke proizvodnje</b></p> <p>1.Za sprovo enje politike obnovljivih izvora energije i zajedni ke proizvodnje, Ministarstvo je dužno da:</p> <p>1.1 izradi dugoro ni i srednjoro ni plan za obnovljive izvore energije i zajedni ku proizvodnju, u skladu sa uslovima EK;</p> <p>1.2 nadgleda sprovo enje Politike obnovljivih izvora energije i zajedni ke proizvodnje; i</p> <p>1.3 postavi ciljeve za koriš enje obnovljivih izvora energije i zajedni ku proizvodnju.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Section 13</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Implementation of the Renewable Energy Sources and Co-generation Policy</b></p> <p>1.For the implementation of the Renewable Energy Sources and Co-generation Policy, the Ministry shall:</p> <p>1.1draft long-term and mid-term plans for renewable energy sources and co-generation, in line with European Community, requirements;</p> <p>1.2 monitor the implementation of the Renewable Energy Sources and Co-generation Policy; and</p> <p>1.3 develop renewable energy targets for the use of renewable energy sources and co-generation.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 14</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Detyrimet e ndërmarrjeve energjetike lidhur me burimet e ripërtëritshme të energjisë dhe bashkëprodhimin</b></p> <p>1.Gjatë dispečimit të energjisë së prodhuar, Operatori i Sistemit të Transmisionit, ose operatori i sistemit të shpërndarjes, sipas nevojës, duhet t’i japin përparësi energjisë së prodhuar nga burimet e ripërtëritshme të</p>	<p style="text-align: center;"><b>lan 14</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Obaveze energetske preduze a oko obnovljivih izvora energije i zajedni ke proizvodnje</b></p> <p>1.Tokom distribucije elektri ne energije, operater sistema prenosa, ili operater distribucionog sistema, u obavezi je da da prednost proizvodnji elektri ne energije iz obnovljivih izvora energije i iz zajedni ke</p>	<p style="text-align: center;"><b>Section 14</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Obligations of Energy Enterprises for Renewable Energy Sources and Co-generation</b></p> <p>1.When dispatching electricity generation, the transmission system operator, or the distribution system operator where appropriate, shall give priority to electricity generation from renewable</p>



<p>energjisë dhe bashkëprodhimi, sipas limiteve të specifikuara për qëllime të sigurimit të sistemit në Kodin e rrjetit dhe në rregullat e kodet tjera;</p> <p>2.Operatorët e sistemit të transmisionit dhe shpërndarjes përcaktojnë dhe publikojnë rregullat standarde mbi bartësin e shpenzimeve të adoptimeve teknike, siç janë kyçjet në rrjet dhe përforcimet e rrjeteve të tyre, të domosdoshme për integrimin e prodhuesve të rinj të energjisë elektrike që furnizojnë me energji elektrike të prodhuar nga burimet e ripërtëritshme të energjisë në sistemin e ndërlidhur. Këto rregulla dorëzohen për miratim në Zyrën e Rregullatorit të Energjisë, dhe duhet të jenë në përputhje me Strategjinë e Energjisë të Kosovës dhe të bazohen në kritere objektive, transparente e jo-diskriminuese, veçanërisht duke marrë parasysh të gjitha shpenzimet dhe përfitimet që dalin nga kyçja e këtyre prodhuesve me sistemin;</p> <p>3.Operatorët e sistemit të transmisionit dhe shpërndarjes duhet t'i sigurojnë çdo prodhuesi të ri të energjisë elektrike që përdorë burime të ripërtëritshme të energjisë apo bashkëprodhim e që dëshiron të lidhet në sistem, vlerësimin e plotë e të hollësishëm lidhur me shpenzimet që krijohen nga kyçja, për të cilin vlerësim</p>	<p>proizvodnje, osim u slu aju ograni enja navedenog u svrhu bezbednosti sistema kako je utvr eno u Kodeksu mreže i drugim pravilima i kodeksima.</p> <p>2.Operatori sistema utvr uju i objavljuju standardna pravila o nosiocu troškova i tehni kih adaptacija, kao što su priklju enja na mrežu i oja avanje mreža, neophodnih za integrisanje nove proizvodnje elektrine energije iz obnovljivih izvora energije u povezani sistem. Ova pravila, koja usvaja Energetska regulatorna kancelarija, moraju biti u skladu sa Energetskom strategijom i zasnovana na objektivnim, transparentnim i nediskriminacionim kriterijumima, posebno uz uzimanje u obzir svih troškova i koristi povezanih sa priklju ivanjem ovih proizvo a a na sistem.</p> <p>3.Operatori sistema prenosa i distribucije dužni su da svakom novom proizvo a u elektrine energije koji koriste obnovljive izvore energije ili zajedni ku proizvodnju, a koji žele da se priklju e na sistem, obezbede obuhvatnu i detaljnu procenu troškova vezanu za priklju ivanje, a za koju procenu operater sistema može da</p>	<p>energy sources and co-generation, subject only to any limits specified for purposes of system security by the Grid Code and other rules and codes.</p> <p>2.Transmission and distribution system operators shall establish and publish standard rules on who bears the costs of technical adaptations, such as grid connections and grid reinforcements, necessary to integrate new electricity generation feeding electricity produced from renewable energy sources into the interconnected system. Such rules shall be submitted for approval to the Energy Regulatory Office, shall be consistent with the Energy Strategy and shall be based on objective, transparent and non-discriminatory criteria, taking particular account of all the costs and benefits associated with the connection of these producers to the system.</p> <p>3.Transmission and distribution system operators shall provide any new electricity producer using renewable energy sources or co-generation wishing to be connected to the system with a comprehensive and detailed estimate of the costs associated with the connection for which estimate the system operator may levy a charge that</p>
---	--	--



